



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/ Ministarstvo obrazovanj i nauke/ Ministry of  
Education and Science*

**Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM)**  
**FTESË PËR APLIKIM**

Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM), duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 12/2023 për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë si dhe Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, nr.090/01B, fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për:

1. Ofrues të programeve të trajnimit të mësimdhënësve në shërbim dhe punonjësve arsimorë; dhe
2. Programe të trajnimit të mësimdhënësve në shërbim dhe punonjësve arsimorë.

Të drejtë aplikimi për ofrues të programeve të trajnimit kanë të gjithë personat juridik të regjistruar në Republikën e Kosovës, si dhe në vendet tjera, që ofrojnë programe për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë.

Institucionet publike, qeveritare, ndërqeveritare dhe organizatat me status të njohur ndërkombëtar që kanë marrëveshje me MASH për ofrimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, njihen si ofrues të aktiviteteve për zhvillim profesional, për periudhën e

kohëzgjatjes së marrëveshjes. Sipas këtij konkursi, këto institucione duhet të aplikojnë për aprovim të programeve të trajnimit.

Të gjitha aplikimet për programe të trajnimit për mësimdhënës dhe punonjës arsimorë, aplikim për herë të parë apo ri-aplikim pas përfundimit të aprovimit paraprak nga MASH (KSHLM), duhet të bëhen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me këtë thirrje dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Bazuar në kërkesat e identifikuara nga DKA dhe shkollat, në Strategjinë e Arsimit 2022-2026, analizat e nevojave për zhvillim profesional të mësimdhënësve të realizuara nga MASH, IPK, FE dhe AAPARr, KSHLM ka përgatitur një listë me fusha prioritare për ngritjen profesionale të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë. Prandaj, inkurajohen ofruesit të aplikojnë me programe të cilat ndërlidhen me fushat prioritare si më poshtë:

<b>Fushat prioritare</b>	<b>Përshkrimi</b>
Edukimi në fëmijërinë e hershme	<p>Programe trajnuese që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, veçanërisht programe që synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Planifikimin, zhvillimin e aktiviteteve edukative në përputhje me nevojat zhvillimore të fëmijës, si dhe vlerësimin dhe dokumentimin e vazhdueshëm të progresit të tyre në të nxënë.</li><li>- aplikimin e strategjive bashkëkohore që mbështesin kujdesin, zhvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme;</li><li>- krijimin e një mjedisi të sigurt, stimulues dhe gjithëpërfshirës, që nxit kureshtjen, kreativitetin dhe të nxënit aktiv përmes lojës dhe ndërveprimit dhe përdorimin e materialeve dhe mjeteve didaktike për punë me fëmijë;</li><li>- edukimin gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimin e kompetencës digjitale të edukatoreve;</li> <li>- bashkëpunimin e vazhdueshëm me prindërit/kujdestar ligjior me qëllim mbështetjen e zhvillimit të gjithanshëm të fëmijëve dhe sigurimin e një vazhdimësie ndërmjet edukimit në institucion dhe në familje.</li> <li>- Mbeshtetjen psiko-emcionale të fëmijëve në kopsht.</li> </ul>
<p>Mësimdhënia dhe nxënia</p>	<p>Programe trajnuese që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies, me tematika specifike për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore në përgjithësi, e veçanërisht programe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me theks të veçantë për lëndët mësimore të fushave: Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë dhe Shkencat e natyrës.</li> </ul> <p>Programet duhet të synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ofrimin e qasjeve metodologjike bashkëkohore për zhvillimin e shkathtësive të lexim-shkrimit dhe matematikës elementare, duke siguruar integrimin e tyre në mënyrë ndërkurrikulare në të gjitha lëndet mesimore.</li> <li>- mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të të nxënit, zhvillimin e mendimit kritik, kreativitetit dhe aftësisë për të nxënë në mënyrë të pavarur si dhe nxënien e integruar, që kanë për bazë zgjidhjen e problemeve, ndërlidhjen e të nxënit më situatat, qasjen e individualizuar, demokratike dhe kreative;</li> <li>- mbështetjen e mësimdhënies dhe nxënies ndërkurrikulare përmes temave që lidhen me edukimin për qytetari demokratike, edukimin për paqe, globalizimin dhe ndërvarësinë, edukimin për media dhe arsimin për zhvillim të qëndrueshëm;</li> <li>- mbështetjen e zhvillimit të praktikës profesionale të mësimdhënësve për planifikim të pavarur, kreativ dhe praktik, si dhe për zbatim efektiv të</li> </ul>

	<p>kurrikulës, duke lehtësuar punën e tyre të përditshme,</p> <p>rritur efektivitetin në mësimdhënie dhe nxënie, dhe duke promovuar mësimdhënie të diferencuar, të bazuar në projekte dhe me nxënësin në qendër;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ofrimin e tematikave specifike që ndihmojnë në identifikimin dhe përdorimin e burimeve, materialeve dhe mjeteve mësimore, si fizike ashtu edhe elektronike.</li> </ul>
<p>Menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë së IEAA</p>	<p>Programe trajnuese që kontribuojnë në përmirësimin e praktikave të menaxhimit të Institucioneve Edukative Arsimore dhe Aftësuese (IEAA), si dhe ngritjen e cilësisë së performancës së mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe vetë institucioneve të arsimit parauniversitar, veçanërisht programeve që synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në detyrë për udhëheqje dhe menaxhim të IEAA-ve;</li> <li>- zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive për zbatimin e fushave të cilësisë, standardeve dhe treguesve të performancës, si pjesë e procesit të vlerësimit të mësimdhënësve, drejtuesëve dhe shkollës;</li> <li>- planifikimin zhvillimor të shkollës duke integruar politikat dhe planet zhvillimore shtetërore, si PZHSh, PZhAK, Strategjinë e Arsimit, etj ;</li> <li>- planifikimin, organizimin dhe zbatimin e programeve dhe aktiviteteve për zhvillim profesional me bazë në shkollë, të mbështetura në nevojat e identifikuara për avancimin e performancës së mësimdhënësve, drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të IEAA-ve;</li> <li>- fuqizimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në shkollë, përmes ngritjes së kapaciteteve të koordinatorit të</li> </ul>

	<p>cilësisë/pedagogut, drejtorit, të kolegëve dhe ekipit për vlerësim të brendëshëm ve kapaciteteve të menaxhmentit dhe stafit profesional të shkollës, përfshirë: drejtorin, zëvendësdrejtorin, koordinatorin e cilësisë, udhëheqësin e aktivitetit profesional, pedagogun, psikologun, mesuesin mbështetës, asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta dhe këshilltarin e karrierës.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësve</p>	<p>Programe trajnuese në fushën e vlerësimit, me qëllim mbledhjen, sistemimin, evidentimin dhe raportimin e të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimor, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe nxënies, veçanërisht programe që synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdorimin e të dhënave të vlerësimit formativ dhe sumativ për reflektim, me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve;</li> <li>- identifikimin, krijimin dhe përdorimin e metodave dhe instrumenteve adekuate të vlerësimit të nxënësve, sipas qëllimeve përkatëse;</li> <li>- analizën dhe interpretimin e të dhënave të vlerësimeve të jashtme, kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe shndërrimin të tyre në objektiva pune, duke i integruar në planet e punës të mësimdhënësve dhe organeve të shkollës;</li> <li>- vlerësimin si proces që u siguron nxënësve informacione kthyes për nivelin e arritjeve të rezultateve të të nxënësve, si dhe ndihmon në identifikimin e metodologjive të të nxënësve për përmirësim dhe avancim;</li> <li>- qasjet dhe metodologjitë për informimin dhe bashkëpunimin me prindërit lidhur me arritjet e nxënësve, si dhe përkrahjen individuale dhe kolektive të tyre.</li> </ul>

<p>Gjithëpërfshirja në Institucione Edukative Arsimore dhe Aftësuese</p>	<p>Programe trajnuese për gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e nxënies përmes mësimdhënies nga mësimdhënësit dhe edukatorët në përgjithësi, dhe në veçanti nga edukatorët dhe mësimdhënësit mbështetës, asistentët dhe mësimdhënësit udhëtues, veçanërisht programe që synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- qasjet e mësimdhënies së individualizuar dhe përfshirjen e gjithë nxënësve në procesin e nxënies, duke marrë parasysh nevojat, potencialet dhe interesat e tyre;</li> <li>- qasjet e mësimdhënies dhe nxënies për grupet e nxënësve të marginalizuar dhe atyre që kanë mbetur prapa në mësim.</li> </ul> <p>Për aftësinë e kufizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimin e njohurive bazë për aftësinë e kufizuar dhe konceptet gjithëpërfshirëse;</li> <li>- zhvillimin dhe përdorimin e materialeve mësimore specifike;</li> <li>- zbatimin e indeksit për gjithëpërfshirje për drejtorët, edukatorët dhe mësimdhënësit, për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse në shkollë;</li> <li>- hartimin dhe zbatimin e planit individual të arsimit;</li> <li>- vlerësimin e fëmijëve përmes Instrumentit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar (KNF);</li> <li>- bashkëmësimdhënien ndërmjet mësimdhënësit të rregullt, mësimdhënësit mbështetës dhe asistentit në klasë, si dhe transferimin e njohurive në praktikë për fëmijët me nevoja te veçanta arsimore në të gjitha nivelet;</li> <li>- adresimin e vështirësive në nxënie të nxënësit në përgjithësi, si dhe për nxënësit me çrregullime si disleksia, disgrafia, diskalkulia dhe vështirësi tjera;</li> </ul>
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- programe specifike për zhvillimin e potencialit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (Komunikimi Alternativ dhe Augmentativ; Teknologjia ndihmëse në arsim gjithëpërfshirës; Integrimi sensorik; Floortime; ABA, TEACH dhe të tjera).</li> </ul> <p>Për talentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikimin, mësimdhënien, nxënien dhe hartimin e planeve individuale për nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, talent dhe dhunti.</li> </ul>
<p>Arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve (AAPARr)</p>	<p>Programe trajnuese që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së AAPARr, veçanërisht programe që synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimin e shkathtësive për zbatimin e kurrikulës bërthamë, si dhe qasjeve metodologjike dhe praktike për planifikimin dhe zbatimin e saj;</li> <li>- ngritjen e shkathtësive pedagogjike për realizimin e mësimit teorik dhe praktik, në kontekst të integritit të kurrikulës bërthamë;</li> <li>- ndërlydhjen e vlerësimit me zhvillimin e kompetencave në procesin e mësimnxënës të profilet përkatëse;</li> <li>- përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve me nevoja të veçanta në procesin e mësimnxënies;</li> <li>- zhvillimin profesional të mësimdhënësve për hartimin e projekt-propozimeve në shkollë dhe përdorimin e pajisjeve specifike në realizimin e praktikës profesionale;</li> <li>- ngritjen e kapaciteteve për realizimin e hulumtimeve në fushen e arsimit dhe aftësimin profesional;</li> <li>- ofrimin e modaliteteve për zhvillimin e programeve të arsimit të të rriturve, përmes kurseve afatshkurtra dhe modulare;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- bashkëpunimin me bizneset për realizimin e praktikës profesionale.</li> </ul>
Zhvillimi i kompetencës digjitale	<p>Programe trajnuese që kontribuojnë në zhvillimin e kompetencës digjitale të mësimeve, menaxhmentit, stafit profesional dhe administrativ të shkollës, bazuar në Kornizën Evropiane DigiCompEdu, DigiCompOrg dhe DigiComp, veçanërisht programe që synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimin e njohurive, shkathësive dhe qëndrimeve të mësimeve për përdorimin kritik, kreativ dhe efektiv të TIK-ut në klasë;</li> <li>- ngritjen e kapaciteteve të mësimeve për përdorimin e programeve dhe platformave të nryshme duke përfshirë edhe IA në procesin e mësimit dhe nxënies;</li> <li>- angazhimin e nxënësve në projekte që zhvillojnë kompetencën digjitale dhe përmirësojnë rezultatet e nxënies;</li> <li>- krijimin dhe përdorimin e materialeve mësimore digjitale përmes platformave përkatëse;</li> <li>- përzgjedhjen dhe përdorimin e materialeve digjitale të sigurta dhe të besueshme;</li> <li>- ndërlidhjen e materialeve mësimore fizike me ato digjitale në procesin mësimor;</li> <li>- organizimin dhe realizimin e mësimit në distancë apo mësimit hibrid nga menaxhmenti dhe mësuesit;</li> <li>- përdorimin e platformave dhe uebsajteve/faqeve të ndryshme në funksion të mësimit, nxënies, zhvillimit profesional të vazhdueshëm, mirëqenies së nxënësve dhe stafit, dhe bashkëpunimit me prindërit;</li> <li>- përdorimin e platformave dhe uebsajteve për çështje administrative.</li> </ul>

## Procesi i vlerësimit

Vlerësimi i aplikacioneve bëhet nga komisione/ekipe ekspertësh të themeluara dhe angazhuara nga Ministria, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 12/2023. Ekspertët shqyrtojnë aplikacionet sipas fushave kurrikulare, nivelit të arsimit dhe udhëzimeve të KSHLM-së, ndërsa KSHLM merr vendim për aprovim ose mosaprovim jo më vonë se 60 ditë kalendarike pas mbylljes së afatit të aplikimit. Vendimet nga KSHLM do të merren me afat vlefshmërie 1+1 vit, si dhe do të përcaktojnë ofruesin, fushëveprimin, programin, tipin e programit, nivelin e licencës për të cilin vlen, si dhe numrin e orëve/kredive.

Kundër vendimit për aprovim apo mosaprovim, pala ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa në Ministri, brenda 30 ditësh nga data e marrjes së vendimit.

### **Dokumentet për aplikim:**

Aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës për ofruesin ose programin, si në vijim:

- Certifikatën e Regjistrimit të organizatës, që dëshmon emrin dhe statusin juridik,
- Statutin e organizatës që dëshmon fushëveprimtarinë e organizatës;
- Programet e ZHPM me të cilat aplikoni, bazuar në fushat prioritare;
- Planin për organizimin, shtrirjen, realizimin e trajnimeve;
- Referencat për aktivitetet e mëhershme të zbatimit të ZHPM (kjo nuk vlen për organizatat të cilat aplikojnë për herë të parë);
- Raport mbi programet e realizuara të ZHPM, duke përfshirë të dhëna për titullin dhe përmbajtjen e programit, numrin e mësimdhënësve të trajnuar për së paku dy vitet e fundit, si dhe buxhetin dhe burimin e tij për realizimin e trajnimeve (kjo nuk vlenë për organizatat të cilat aplikojnë për herë të parë);
- Të dhëna (CV-të dhe biografi) për personelin udhëheqës për menaxhimin e programeve, si dhe personelin përgjegjës për realizimin e aktiviteteve trajnuese të organizatës;
- Dëshmi për kapacitetet infrastrukturore dhe organizative për realizimin e trajnimeve;
- Formularët e Aplikimit, me të dhëna të përcaktuara në Nenin 5 të UA 12/2023. Formularët duhet të jenë të nënshkruar dhe vulosur.

- Vërtetim nga gjykata që subjekti juridik aplikues nuk është nën hetime ose në procedurë të falimentimit ose shuarjes.
- Vërtetim nga ATK-ja që subjekti juridik nuk ka obligime tatimore të papërbushura
- Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në pliko të mbyllur.

### **Formularët për aplikim:**

1. FORMULAR APLIKIMI PËR OFRUES TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT PËR MËSIMDHËNËS DHE PUNËTORË ARSIMOR:  
[FORMULAR APLIKIMI Nr. 1 - PËR OFRUES TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT PËR MËSIMDHËNËS DHE PUNËTORË ARSIMORË - MASH](#)
2. FORMULAR APLIKIMI PËR PROGRAME TË TRAJNIMIT PËR MËSIMDHËNËS DHE PUNËTORË ARSIMORË:  
[FORMULAR APLIKIMI Nr. 2 - PËR PROGRAME TË TRAJNIMIT PËR MËSIMDHËNËS DHE PUNËTORË ARSIMORË - MASH](#)

**Aplikimi mund të bëhet nga data 18.06.2026 deri me datë 17.07.2026, brenda orarit të rregullt të punës në MASH.**

**Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASH-it, zyra nr. 04.**